REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 556/25 Dt. 18.09.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, konform kërkesës së Operatorit Ekonomik (kompania punë kryerëse) për lejimin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: "Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët, kanalizimi, ujësjellësi dhe ndriçimi publik) në fshatin Zhur", kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 7644.52. € (shtatëmijë e gjashtëqind e katërdhjetë e katër euro e pesëdhjetë e dy cent).

2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-23-6426-5-2-1, me GOE "Flamuri V" Shpk, "Benita Company" dhe "Besioni" Shpk.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nr. 55759.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.